



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 483/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik LDK dega në Prizren, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 16:01, në ditën e zgjedhjeve kemi vërejtur se në qendrën e votimit, në Shkollën Teknike në Prizren 2042A, aktualisht po qëndron duke bërë presion të vazhdueshëm një kandidat për asamble dhe militant i PDK-së Sefedin Morina. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografit si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 të LZP-së, parashihet se “ Mund të apelohe vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar.

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LDK pretendohet se në qendrën e votimit në Prizren në Shkollën Teknike 2042A, aktualisht po qëndronte duke bërë presion kandidati për asamble komunale Sefedin Morina. Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të LDK ndaj subjektit politik PDK-së. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasiqë

dëshmitë e ofruara janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

Andaj PZAP-i, i vlerëson si të pabaza dhe të pa argumentuara duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3.6 pika c) Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 483/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (24)orë nga moment i marrjes së këtij vendimi nga PZAP-i.